HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH.A
BORDI I DREJTORËVE

Nr. III/44
Datë: 28.06.2022

Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 162 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A në Mbledhjen Nr. 42, të mbajtur më 28.06.2022 nxori këtë:

VENDIM

Pas shqyrtimit të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit mbi auditimin e pasqyrave financiare të HK-Trainkos Sh.A për vitin 2021, Bordi i Drejtorëve njëzëri e miratoi atë së bashku me Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2021.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	**Gelor SHALA** **Kryeshef Ekzekutiv**	**Ramush AHMETAJ** **Kryesuesi i BD**
Nënshkrimi:		
Data:	**28.06.2022**	**28.06.2022**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE
Numri Org. Jedin. Org. Unit | Sht.klasifi. Klasif. Kod Class. Code | Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. | Nr. faqeve Br. Strana No. Pag
05 | 47 | 1019 | 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.O.O.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 107/44
Dt. 28.06.2022
Fushë Kosovë - Fushe Kosova - Kosovo Polje

Për	Ramush Ahmetaj, Kryesues i Bordit të Drejtorëve të Trainkos sh.a Gelor Shala, Kryeshef Ekzekutiv i Trainkos sh.a
Kopje elektronike:	Hykmete Bajrami, Kryesuese e KMFP dhe Koordinatorit të KMFP Armend Muja, Kryesues i KBT dhe Koordinatori i KBT Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë, Adem Ahmetaj, zv. Udhëheqës i Njësia për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
Nga:	Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës
SUBJEKTI:	Raporti i auditimit të Trainkos sh.a. për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2021

Nr. Zyrës:	**Ext:**	**Data:** 16.06.2022

Data	Zyra e Pranimit	Komentet/Veprimet	Inicialet	Afati
		Bashkangjitur mund të gjeni raportin e auditimit të Trainkos sh.a. për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2021. Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Pëgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzoj një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.		

TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.Prot.Br. III/44
Dt. 28.06.2022
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË NDËRMARRJES PUBLIKE HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS, SH. A. PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh. a. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh. a. (Trainkos sh. a.), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin "Baza për Opinion të Kundërt", Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh. a. deri me 31 dhjetor 2021, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2021, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kundërt

A1 Në pasqyrën e pozicionit financiar, kompania kishte prezantuar detyrimet ndaj grantit në vlerë neto 695,019€ ndërsa sipas regjistrit të pasurive vlera neto e financimeve nga grantet, ishte 2,142,977€, që rezulton me një diferencë prej 1,447,958€;

A2 Me rastin e konfirmimit të llogarive të arkëtueshme kemi vërejtur se gjendja e borxhit të një klienti ishte prezantuar në shumën 650,938€, ndërsa sipas konfirmimit të pranuar nga klienti obligimi ndaj Trainkos ishte 588,073€, që rezulton me një mbivlerësim të kësaj llogarie për 62,865€. Po ashtu, në dy raste kemi identifikuar mospërputhje të llogarive të arkëtueshme. Sipas shënimeve kontabël respektivisht PFV për dy rastet vlera e llogarive të arkëtueshme ishte 18,249€ ndërsa sipas letër konfirmimeve të pranuara nga klientët vlera e llogarive të arkëtueshme ishte 5,596€. Pra, ekziston një mbivlerësim i të arkëtueshmeve për 12,653€;

A3 Në pasqyrën e pozicionit financiar kompania kishte prezantuar obligime tatimore në shumën 609,527€ ndërsa bazuar në deklaratën e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), gjendja e obligimeve të ndërmarrjes në fund të vitit 2021 ishte 683,618€. Si rezultat i kësaj detyrimet e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar ishin të nënvlerësuara për 74,091€.
Vlen të theksohet se shpenzimet e ndëshkimeve dhe interesit të cilat i takojnë periudhës raportuese të vitit 2021 ishin 59,995€, ndërsa në pasqyra financiare ndërmarrja i kishte prezantuar në shumë 137,444€, me një mospërputhje prej 77,449€; dhe

B1 Procesin e vlerësimit të pasurive për herë të fundit kompania e kishte realizuar në vitin 2007 para se të ndodhte procesi i ndarjes me HK Infrakos. Si rezultat i kësaj në regjistrin kontabël figurojnë një numër i pasurive (77) me kosto historike në shumën prej 5,514,291€ dhe që janë të zhvlerësuara në tërësi, pra me vlerë neto në libra zero (0). Edhe pse këto pasuri ende janë aktive për të njëjtat nuk ishte bërë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre prej 14 vitesh. Andaj ne nuk ishim në gjendje që të vlerësojmë nëse vlera e tyre ishte prezantuar drejtë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh. a. kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A4 Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar obligime tatimore ndaj pagave për periudhën 2019-2021 në shumë prej 288,491€ dhe obligime ndaj kontributeve pensionale për vitin 2020 dhe 2021 në shumë prej 319,918€ të cilat nuk ishin paguar sipas afateve mujore të paracaktuara me ligj.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'.
Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh. a..

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh. a. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh. a. në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[2]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet qe të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh. a. me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh. a..

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos, sh. a., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm se deri në çfarë mase ato janë adresuar. Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime të reja dhe dy (2) të përsëritura ndërsa, për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mos përputhje në mes granteve të shtyra dhe aseteve të financuara nga grantet e shtyra

Gjetja

SNK 20, përcakton se Grantet qeveritare që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e bilancit ose duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë - detyrime ndaj grantit. Grantet e lidhura me aktivet e amortizueshme, zakonisht njihen si të ardhura gjatë periudhave dhe në raportet në të cilat ngarkohet amortizimi lidhur me këto aktive.

Në pasqyrën e pozicionit financiar, kompania kishte prezantuar detyrimet ndaj grantit në vlerë neto 695,019€ ndërsa sipas regjistrit të pasurive vlera neto e financimeve nga grantet, ishte 2,142,977€, që rezulton me një diferencë prej 1,447,958€.

Veç kësaj, përkundër faktit që sipas vendimit shpjegues të Administratës Tatimore që projektet të cilat financohen nga grantet janë të liruara nga TVSh, ne kemi vërejtur që ndërmarrja kishte regjistruar me TVSh tetë (8) faturat e paguara nga grantet, ndërsa asetet e financuara nga këto grante i kishte regjistruar pa TVSh. Si rrjedhojë e kësaj, grantet e shtyra (detyrimet ndaj granteve) nuk ishin të sakta për 266,811€.

Bazuar në konfirmimet zyrtare kjo kishte ndodhur për shkak se në kuadër të listës të pasurive të financuara nga grantet, ishin përfshirë edhe donacionet dhe pastaj kjo kishte ndikuar në zvogëlimin e detyrimeve ndaj grantit.

Ndikimi

Mos trajtimi i duhur i pasurive të financuara nga grantet ndikon në mos prezantim të saktë të vlerës së granteve në pasqyrën e pozicionit financiar, me efekt keqdeklarimi edhe në pasqyrat tjera financiare.

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se vlera e detyrimeve ndaj grantit të njihet dhe prezantohet saktë në PFV si dhe të merren masat e nevojshme korrigjuese për gabimet në lidhje me regjistrimet e pasurive të financuara nga grantet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme dhe mbivlerësim i të hyrave

Gjetja

Kontrata për Transportin Lokal dhe Ndërkombëtar të mallrave në mes të Trainkos dhe Ndërmarrjes Feronikel e lidhur me datën 27.08.2018, dhe aneks kontratës të datës 05.01.2021 përkatësisht neni 4.3 Luhatja e çmimit të naftës përcakton se: "Klienti dhe Kontraktori bien dakord të takohen përsëri në tre muaj për të kontrolluar lëvizjet e ndryshimit të çmimit të naftës dhe ndikimin e saj në çmimin e shërbimeve. Nëse çmimi mesatar i naftës i çerekut luhatet më shumë se +/- 10% nga çmimi origjinal i naftës, atëherë të dy kompanitë do të bëjnë përmirësime të çmimit sipas formulës të përcaktuar me këtë kontratë".

Ligjit Nr. 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim përkatësisht neni 12, pika 2 ndër tjera përcakton se: Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme kemi vërejtur se në librat kontabël të Trainkos gjendja e borxhit të Feronikelit ishte 650,938€ ndërsa sipas konfirmimit nga klienti, obligimi ishte 588,073€. Pra, kishte një mospërputhje të llogarive për 62,865€. Kjo diferencë ishte si rezultat i mos aplikimit të zbritjeve nga Trainkos për 51,764€, përkundër faktit që nga klienti kishte pranuar dëshmitë për zbritjet (debit nota). Ndërsa, diferenca prej 11,101€ ndërlidhet me paqartësi në mes klientit dhe ndërmarrjes.

Po ashtu, në dy raste përmes letër konfirmimeve kemi identifikuar mospërputhje të llogarive të arkëtueshme. Sipas shënimeve kontabël, për dy rastet vlera e llogarive të arkëtueshme ishte 18,249€ ndërsa sipas letër konfirmimeve të pranuara nga klientët vlera e tyre ishte 5,596€, që rezulton me një mbivlerësim të llogarisë prej 12,653€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se palët nuk ishin takuar në periudha të rregullta për të kontrolluar lëvizjet e ndryshimit të çmimit të naftës dhe ndikimin e saj në çmimin e shërbimeve. Edhe pse Ndërmarrja Trainkos kishte bërë kërkesë për takime me klientin, takimet e tilla nuk kishin ndodhur nën arsyetimin se klienti nuk kishte punuar në disa periudha gjatë vitit 2021. Si shkak tjetër është edhe mos barazimi periodik me klientët.

Ndikimi Mos korrigjimi i çmimit të naftës si dhe mos barazimet periodike kanë ndikuar në mbivlerësimin e llogarive të arkëtueshme, dhe si rrjedhojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi A2 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të fuqizohen kontrollet e brendshme në mënyrë që zbritjet (debit notat) nga klientët të aplikohen dhe të merren hapat e nevojshëm që ato të trajtohen sipas kushteve të kontratës si dhe të merren veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet ndërmarrjes dhe klientëve të saj në baza periodike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Nënvlerësim i obligimeve tatimore dhe mosprezantim i saktë i shpenzimeve të interesit dhe ndëshkimeve tatimore

Gjetja

Sipas SNK 1, përkatësisht paragrafi 13, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon paraqitje besnike të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të dhëna në Kuadër.

Ndërmarrja në pasqyrën e pozicionit financiar kishte prezantuar obligime tatimore në vlerë 609,527€, ndërsa bazuar në deklaratën e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) gjendja e obligimeve të ndërmarrjes në fund të vitit 2021 ishte 683,618€ përfshirë ndëshkimet dhe interesin. Si rezultat i kësaj detyrimet e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar ishin të nënvlerësuara për 74,091€.

Për më tepër, ndërmarrja në qershor të vitit 2021 kishte hyrë në marrëveshje me ATK për pagesën e borxheve tatimore, me ç'rast kishte përcaktuar që pagesa e borxheve të bëhet me këste mujore ndaj ATK-së.

Vlen të theksohet se shpenzimet e ndëshkimeve dhe interesit të cilat i takojnë periudhës raportuese të vitit 2021 ishin 59,995€, ndërsa në pasqyra financiare ndërmarrja i kishte prezantuar në shumë 137,444€. Pra, shpenzimet e prezantuara në pasqyrën e të ardhurave ishin mbivlerësuar për 77,449€.

Nënvlerësimi i obligimeve tatimore kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme nga departamenti i financave ndërsa mos prezantimi i saktë i shpenzimeve në pasqyrën e të ardhurave kishte ndodhur për shkak se, shpenzimet e ndëshkimit dhe interesit, nuk ishin regjistruar në vitet e mëhershme dhe si rrjedhojë e kësaj ato janë akumuluar dhe janë regjistruar në vitin 2021 si shpenzime të akumuluara.

Ndikimi Mos prezantimi i saktë i obligimeve tatimore, shpenzimeve të interesit dhe ndëshkimeve ka ndikuar në keqdeklarim të obligimeve tatimore, dhe rrjedhimisht edhe në prezantim jo të drejtë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A3 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kontrollet financiare të jenë më efektive dhe azhurnimi i të dhënave të bëhet me kohë në mënyrë që llogaritë tatimore dhe regjistrimet kontabël të reflektojnë prezantimin e drejtë të gjendjes në pasqyra financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Mos rivlerësimi i pasurive afatgjata

Gjetja Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 16, aktivet afatgjata materiale përcakton se: rivlerësimet duhet të bëhen në mënyrë të rregullt çdo tre deri pesë vjet, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Procesin e vlerësimit të pasurive për herë të fundit kompania e kishte realizuar në vitin 2007 para se të ndodhte procesi i ndarjes me HK Infrakos. Si rezultat i kësaj, në regjistrin kontabël figurojnë një numër i pasurive (77) me kosto historike në shumën prej 5,514,291€ dhe që janë të zhvlerësuara në tërësi, pra me vlerë neto në libra zero (0). Edhe pse këto pasuri ende janë aktive, për të njëjtat nuk ishte bërë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre prej 14 vitesh. Andaj ne nuk ishim në gjendje që të vlerësojmë nëse vlera e tyre ishte prezantuar drejtë.

Shkak i mungesës së rivlerësimit të pasurive ishte mungesa e kontraktimit të një vlerësuesi të pavarur të licencuar për vlerësim të pasurive. Kjo kishte ndodhur edhe përkundër faktit që ndërmarrja kishte iniciuar procesin e kontraktimit për vlerësues të pasurive por procedura e kontraktimit kishte dështuar gjatë vitit 2021.

Ndikimi Mos kryerja e rivlerësimit të pasurive të cilat veç se janë në përdorim, rritë rrezikun që vlera kontabël e tyre e prezantuar në pasqyra financiare të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e drejtë.

Rekomandimi B1 Bordi i Drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime konkrete për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në pesë (5) vite.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A4 - Mos pagesa e kontributeve pensionale dhe obligimeve tatimore

Gjetja

Ligji nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale, neni 38.1 thekson se: secili punëdhënës është përgjegjës të mbajë në burim tatimin nga pagat e tatueshme të paguara të punëtorëve të tij, si dhe neni 6.3 i Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, thekson se punëdhënësi zbret kontributin pensional të punonjësve nga rrogat e punonjësve dhe e bartë në llogarinë e posaçme të fondit bashkë me kontributin e punëdhënësit në afatin e duhur në përputhje me rregullat që do të nxirren në mënyrën që e cakton ATK. Gjithashtu, sipas nenit 6.13 të ligjit të mësipërm, pagesa e kontributeve është e detyrueshme për të gjithë banorët e punësuar të Kosovës deri në moshën e pensionimit.

Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar obligime tatimore ndaj pagave në vlerë 288,491€ që nga viti 2019 deri në vitin 2021 dhe obligimet ndaj kontributeve pensionale në vlerë prej 319,918€ për periudhën 2020-2021 të cilat nuk ishin paguar sipas afateve mujore të paracaktuara në ligj.

Vlen të theksohet se ndërmarrja në qershor të vitit 2021 kishte hyrë në marrëveshje me Administratën Tatimore për pagesën me këste të këtyre obligimeve.

Sipas shpjegimeve të menaxhmentit, mos pagesa e këtyre detyrimeve është si rezultat i gjendjes së vështirë financiare të kompanisë.

Ndikimi

Mos pagesa e detyrimeve tatimore ndaj pagave dhe kontributeve pensionale, rritë rrezikun që të aplikohen ndëshkime nga autoritetet tatimore për mos pagesë të obligimeve në afatin kohor. Kjo ka ndikim edhe në depozitat kursimore në Trustin Pensional të Kosovës, dhe rrjedhimisht edhe në pagesën e pensioneve më të vogla për punëtorët kur pensionohen, çka përbën shkelje ligjore të të drejtave të punëtorëve.

Rekomandimi A4

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj se të gjitha obligimet e prapambetura të kontributeve pensionale të paguhen sa më parë, si dhe të ndërpritet praktika e pagesës së pagave, pa pagesën edhe të tatimeve dhe kontributeve në paga.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Kontrollet e brendshme në raportimin financiar

Çështja A5 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese

Gjetja	SNK 1 përcakton se, shënimet shpjeguese janë një element i pandarë i pasqyrave financiare. Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, prezantojnë informacionet shtesë në mënyrë që të plotësohen nevojat e përdoruesve me informacion mbi përbërjen e elementeve të bilancit dhe pasqyrës së të ardhurave. Ato zakonisht përmbajnë informacion edhe për politikat kontabël të përdorura nga njësia ekonomike për hartimin e pasqyrave financiare. Ndërmarrja kishte përpiluar shënimet shpjeguese si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, megjithatë informacioni i dhënë nga kompania në shënimet shpjeguese është i mangët në lidhje me politikën kontabël të matjes së stoqeve, shpenzimet e interesit dhe ndëshkimeve, si dhe analitikën e shpenzimeve. Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtarët e ndërmarrjes i kishin konsideruar si të mjaftueshme informacionet e prezantuara në shënimet shpjeguese.
Ndikimi	Mos paraqitja e plotë e shënimeve shpjeguese shkakton paqartësi dhe kufizime në leximin e pasqyrave dhe ndikon që përdoruesit e pasqyrave financiare të mos kenë informacionet e plota.
Rekomandimi A5	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që shënimet shpjeguese, përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacione mbi përbërjen e zërave të pasqyrave, janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Stoqet

Në kuadër të pasurive afatshkurtëra ndërmarrja kishte prezantuar stoqet në vlerë 432,761€, dhe gjatë auditimit kemi vërejtur mangësitë të cilat janë shpalosur në vijim.

Çështja A6 - Mos harmonizimi i gjendjes së stokut me regjistrat kontabël

Gjetja	Ligji Nr.06/L- 032,për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe auditim, neni 12 përcakton se shoqëritë tregtare të paktën një herë në vit duhet të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre zërave dhe dëshmive të tyre mbështetëse Gjendja e stoqeve në pasqyrat financiare vjetore ishte prezantuar në shumë prej 432,761€, ndërsa sipas komisionit të inventarizimit/numërimit fizik, vlera e tyre ishte 429,804€, me një diferencë prej 2,957€. Kjo kishte ndodhur për shkak se komisioni inventarizimit e kishte hartuar raportin numërimit fizik të stokut, por departamenti i financave nuk i kishte harmonizuar shënimet me librat kontabël.
Ndikimi	Mos harmonizimi i gjendjes faktike të stoqeve (pasurive) me regjistrat kontabël ndikon në prezantimin e gjendjes jo reale të stokut, dhe rrjedhimisht, edhe në prezantimin dhe shpalosjen jo të duhur të vlerës së tyre në pasqyra financiare.
Rekomandimi A6	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që me rastin e inventarizimit të stoqeve, të bëhet harmonizimi i gjendjes faktike të stoqeve me regjistrat kontabël në mënyrë që të prezantohet vlera e drejtë e tyre në pasqyra financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Parapagimet

Në kuadër te pasurive afat shkurtra ndërmarrja kishte prezantuar parapagime në vlerë 20,585€, dhe gjatë auditimit kemi vërejtur mangësitë si në vijim.

Çështja B2 - Mungesë e dëshmive burimore për parapagimet

Gjetja	Sipas SNK 1 Shpenzimet e parapaguara shfaqen atëherë kur paguhet paraja para se të përdoret artikulli, shërbimi apo dobia, ndërsa shpenzimet përkatëse njihen gjatë periudhës përkatëse të pranimit të tyre. Në kuadër të zërit pasuritë tjera afatshkurtëra, ndërmarrja kishte regjistruar edhe parapagime në vlerë 20,585€. Lidhur me këtë, ne kemi kërkuar shpjegime për këto parapagime, por ndërmarrja nuk kishte arritur të na sigurojë dëshmitë e kërkuara për vlerën 6,055€. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos rishikimit periodik të informacioneve financiare në sistemin e kontabilitetit dhe harmonizimit të shënimeve të ndërmarrjes me furnitorët respektiv për t'i identifikuar dhe trajtuar këto pasuri.
Ndikimi	Mungesa e kontrolleve efektive në trajtimin e parapagimeve si dhe mungesa e evidencave kontabël, të cilat konstatojnë të drejtën e ndërmarrjes mbi to, ndikon në prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyrën e pozicionit financiar.
Rekomandimi B2	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se ekzistojnë të gjitha dëshmitë e duhura valide që konfirmojnë të drejtat e ndërmarrjes për këto parapagime. Në të kundërtën, në qoftë se nuk konstatohen të drejtat e ndërmarrjes për këta furnitorë, të bëj korrigjimet e duhura kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të hyrat

Të hyrat e realizuara gjatë vitit 2021 ishin 2,813,942€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga transporti i mallrave, transporti i udhëtarëve, të hyra nga ministritë dhe të tjera.

Çështja A7 - Mos klasifikim i saktë i të ardhurave nga shitja e aseteve

Gjetja

Bazuar në SNK 16, Një njësi ekonomike nuk mund të klasifikojë si të ardhura një fitim që realizon nga nxjerrja jashtë (shitja) përdorimit të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje). Kjo sepse të ardhurat nga shitja e të mirave zakonisht ka më shumë mundësi të përsëritet në shuma të krahasueshme sesa janë fitimet neto nga shitja e zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje). Tutje, Fitimi ose humbja që vjen nga mosnjohja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të përcaktohet si diferenca mes shumës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi, nëse ka, dhe vlerës kontabël (neto) të zërit.

Gjatë vitit 2021 ndërmarrja kishte shitur një numër të pasurive për skrap, të cilat kishin vlerë neto në libra 25,657€. Çmimi i shitjes së aseteve ishte 235,190€ (pa TVSh), të cilën ndërmarrja e kishte njohur si të ardhur nga shitja e skrapit në vlerën totale të shitjes. Ndërsa, sipas kërkesave të standardeve shitja e aseteve duhet të trajtohet si diferencë në mes të vlerës shitëse dhe vlerës neto të pasurive. Pra, kjo do duhej të trajtohej si fitim nga shtija e pasurive, dhe jo si e ardhur operative.

Sipas zyrtarëve të kompanisë kjo kishte ndodhur për shkak të kujdesit të pa mjaftueshëm nga departamenti i financave dhe si rrjedhojë e saj ishte bërë klasifikimi i tillë.

Ndikimi

Prezantimi i shitjes së aseteve si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave, ndikon në prezantim jo të saktë të informacionit financiar për aktivitetet operative.

Rekomandimi A7

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se me rastin e shitjeve të pasurive, të bëhet trajtimi i duhur i tyre bazuar në kërkesat e standardeve të kontabilitetit me qëllim që efektet e shitjes së pasurive të pasqyrohen drejtë në kontabilitet dhe pasqyra financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur për të ofruar siguri objektive dhe një aktivitet këshillues, i dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e kompanisë. Po ashtu, ndihmon për përmbushjen e objektivave, duke nxitur një qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit në menaxhimin e rrezikut, kontrolleve dhe proceseve të qeverisjes.

Çështja A8 - Mos hartimi i Statutit të Auditimit të Brendshëm

Gjetja	Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (SNPPAB) 1000 parashohin që qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm duhet të përcaktohet formalisht në Statutin e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës dhe Standardeve. Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk kishte hartuar Statutin e Auditimit të Brendshëm, edhe pse kjo kërkohet me Standarde Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm. Shkak i mos hartimit të statutit të auditimit të brendshëm ishte mungesa e vëmendjes së duhur nga nivelet drejtuese duke përfshirë bordin e drejtorëve dhe komisionin e auditimit.
Ndikimi	Mungesa e statutit të auditimit të brendshëm mund të ndikojë në paqartësitë lidhur me fushëveprimin, metodologjitë dhe përgjegjësitë e funksionit të auditimit të brendshëm të ndërmarrjes dhe në performancën e angazhimit të stafit auditues.
Rekomandimi A8	Bordi i Drejtorëve në bashkëpunim më Komisionin e Auditimit duhet të sigurojë që është hartuar Statuti i Auditimit të Brendshëm, i cili përcakton natyrën e shërbimeve që do të ofrohen brenda ndërmarrjes, pozicionin, autoritetin dhe përgjegjësinë e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në kompani.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës -Trainkos sh. a. ka rezultuar me 9 rekomandime. Ndërmarrja kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, pesë (5) rekomandime ishin zbatuar, dy (2) nuk ishin zbatuar dhe dy (2) ishin te mbyllura të pa zbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr. 1.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2021

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime konkrete për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në (5) pesë vite. Kjo me qëllim të paraqitjes së vlerës reale të pasurive, në përputhje me kërkesat e SNK 16.	Trainkos kishte zhvlilluar një procedurë të prokurimit në 2020 për vlerësimin e pasurive, mirëpo ajo procedurë ishte anuluar.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për opinion	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet ndërmarrjes dhe furnitorëve të saj në baza periodike në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të pagueshme. Ndërsa për detyrime që janë me të vjetra se 10 vite të tratjohen në pajtim me ligjin nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat sendore.	Ndërmarrja kishte formuar një komision për trajtimin e llogarive te pagueshme dhe këtë çështje e kanë adresuar.	I zbatuar

3.	Baza për opinion	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për të aplikuar drejtë metodologjinë e trajtimit dhe njohjes së të ardhurave nga grantet dhe të zhvlerësimit të tyre në kontabilitet dhe në PVF	Lidhur me këtë ne nuk kemi identifikuar gjatë vitit 2021 mangësi të natyrës se tillë dhe konsideroj që kjo çështje është adresuar.	I zbatuar
4.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e të dhënave ndërmjet ndërmarrjes dhe klientëve të saj në baza periodike në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të arkëtueshme.	Ndërmarrja kishte ndërmarrë veprimet lidhur me këtë dhe konsiderojmë se rekomandimi është adresuar.	I zbatuar
5.	Parapagimet	Bordi i drejtorëve të sigurojë se ekzistojnë dëshmi valide dhe kredibile për të konfirmuar të drejtat e ndërmarrjes për këto parapagime. Në të kundërtën në qoftë se nuk konstatohen të drejtat e ndërmarrjes për këta furnitorë të sigurojë se janë larguar nga regjistri i parapagimeve të ndërmarrjes.	Ndërmarrja nuk kishte arritur të adresojë këtë rekomandim dhe gjendja është e ngjashme edhe në vitin aktual.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i drejtorëve të sigurojë krijimin e një mekanizmi të kontrollit që monitoron të gjitha detyrimet ndaj operatorëve ekonomik në mënyrë që faturat të paguhen brenda afateve kohore të përcaktuara në kushtet me kontratën në mes të dy palëve	Ndërmarrja kishte lidhur një marrëveshje për pagesën e borxhit me këste de konsideroj që janë marr veprimet e nevojshme.	I zbatuar
7.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për harmonizimin periodik të kartelave financiare mes ndërmarrjes dhe furnitorëve në mënyrë që të këtë pasqyrë sa më të qartë për detyrimet e saj ndaj furnitorëve.	Lidhur me këtë ne nuk kemi identifikuar gjatë vitit 2021 mangësi të natyrës se tillë dhe konsideroj që kjo çështje është adresuar.	I zbatuar
8.	Të hyrat	Bordi i drejtorëve të siguroj se ofrimi i shërbimeve bëhet vetëm për ato veprimtari të cilat janë të përcaktuara me statut dhe të marr masat e duhura për ndërprerjen e shitjes së naftës ndaj ndërmarrjes tjetër. Po ashtu të rishikojë marrëveshjen duke i përjashtuar të gjitha ato punë dhe shërbime që mund të ofrohen direkt nga operator tjerë ekonomik dhe që nuk janë veprimtari statutore e ndërmarrjes.	Lidhur me këtë, ndërmarrja çështjen e tillë e kanë të rregulluar me marrëveshjen e brendshme në mes të Trainkos-it dhe Infrakos-it.	Nuk është i aplikueshëm më

9.	Shpenzimet e pagave	Bordi i drejtorëve të siguroj se stimujt e veçantë të jepen vetëm në bazë të procedurës zyrtare të miratuar nga Bordi, e cila do të duhej të siguronte transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë punonjësit e ndërmarrjes.	Çështje lidhur me kompensimet për e stafit për covid në vitin 2021 nuk kishte dhe konsideroj rekomandimi është i mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit

Valmira Jonuzi, Udhëheqëse e ekipit

Lindita Ajeti, Anëtare e ekipit

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mos përputhje në mes granteve të shtyra dhe aseteve të financuara nga grantet e shtyra	Gjetja është kundërthënëse me procesin e auditimeve tjera të vitit 2018, 2019 dhe 2020. Ne jemi audituar gjatë viteve paraprake konkretisht për këtë pikë dhe nuk kemi pasur gjetje me kaq diferencë të madhe dhe kemi patur Opinion të Kualifikuar. Çështja tjetër në vazhdim të kësaj pike, Auditori i referohet vendimit shpjegues publik nr.04/2016 të ATK-së i cili i trajton donacionet e jo grantet. Donacione ndërmarrja jonë nuk ka pranuar që nga themelimi i sajë.	Komenti i entitetit lidhur me çështjen është i pa bazuar. Çështjet e ngritura në raport i referohen pasqyrave financiare të vitit audituesi, dhe jo viteve të mëhershme. Sipas trajtimit kontabël, të cilin e rregullon SNK 20, Grantet qeveritare që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e bilancit ose duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e bartur e aktivit. Kompania kishte prezantuar Grante të shtyra neto në pasqyrën e pozicionit financiar, të cilat lidhen me financimin e aktiveve (pasurive) 695,019€. Ne kemi kërkuar nga kompania listën e aktiveve të financuara nga grantet, ku vlera neto e aktiveve më 31.12.2021 ishte 2,142,977€. Pra, nuk përputhet me vlerën neto në PVF. Ndërsa, lidhur me terminologjinë e përdorur nga entiteti për grantet, komenti ynë është se: Grantet sikurse edhe donacionet janë mbështetje financiare, por dallimi qëndron në trajtimin kontabël pasi që grantet lidhen detyrimisht me projektin e caktuar, njihet si pasuri dhe njëkohësisht detyrim - të hyra të shtyra, ndërsa nëse pranohen donacione pa destinim për projekte kapitale por për mbulim të shpenzimeve tjera atëherë këto donacione trajtohen si të ardhura tjera në pasqyrën e të ardhurave. Pra, në rastin konkret kemi të bëjmë me dhënie të fondeve përmes granteve, ku palët lidhin një marrëveshje të veçantë për destinimin e fondeve. Po ashtu, në aspektin kontabël, kompania kishte regjistruar gabimisht pasuritë pa TVSh, duke e ndarë atë si TVSh të zbritshme, ndërsa, grantin e shtyrë e kishte regjistruar me TVSh.

Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme dhe mbivlerësim i të hyrave	Ne kemi paraqitur arsyetimet tona, gjithashtu e kemi prezantuar edhe leterkonfirmimin nga FERRONIKELI ku e pranon që ajo ka regjistruar debit notat pa ja konfirmuar TRAINKOS dhe ka pranuar që ka veprur njëanshëm. Letërkonfirmimin nga FERRONIKELI me mbishkrim e kemi dorëzuar tek auditorët.	Komenti i entitetit lidhur me çështjen është i pa bazuar. Debit notat janë dërguar nga Feronikeli gjatë periudhës janar-korrik vitit 2021, por nuk janë regjistruar në kontabilitet nga Ndërmarrja Trainkos. Në bazë të letër konfirmimit të pranuar nga Feronikeli shihet qartë se Trainkos është dakorduar me zbritjet e aplikuara nga klienti. Dhe duke qenë se ekzistojnë obligime të përcaktuara me kontratë sa i përket luhatjeve të çmimeve, atëherë ndërmarrja do të duhej të bënte regjistrimin e zbritjeve në kontabilitet, por një veprim të tillë nuk e kishte bërë. Prandaj, gjetja si e tillë nuk ndryshon.
Nënvlerësim i obligimeve tatimore dhe mosprezantim i saktë i shpenzimeve të interesit dhe ndëshkimeve tatimore	ZKA ka dërguar letërkonfirmimet tek klientët dhe funitorët me të cilat bazohet dhe argumenton LL/A dhe LL/P të ndërmarrjes. Në rastin e ATK-së, ZKA nuk ka pranuar letërkonfirmim nga ATK, dhe si rrjedhojë nuk mund të merret e saktë vlera e prezantuar pa letër konfirmim. Nëse ZKA ka pranuar letërkonfirmim që e dëshmon këtë vlerë të paraqitur në këtë gjetje, ne do të pajtohemi!	Komenti i entitetit lidhur me çështjen është i pa saktë. ZKA në rastet kur nuk pranon letër konfirmime nga ana e palëve, kryen procedura shtesë alternative të auditimit. Prandaj, sipas dokumenteve të siguruara nga Administrata Tatimore e Kosovës, gjendja e obligimeve nuk është e njëjtë me gjendjen e obligimeve që e ka raportuar ndërmarrja në pasqyra financiare. Gjithashtu, problemi tjetër qëndron se, kompania ka hyrë në marrëveshje kontraktuale me ATK gjatë vitit 2021, për të bërë pagesat e obligimeve, ndëshkimeve dhe interesit të cilat datojnë që nga 2012. Sipas kësaj marrëveshje, kompania do të paguaj me këste obligimet e lartpërmendura.

TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. III/39
Dt. 14.06.2022
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH.A

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar.

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të Hekurudhave të Kosovës – Trainkos sh.a, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- Pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet në draft-raport. Për çështjet mospajtuese, bashkangjitur me këtë letër konfirmim do te jenë edhe komentet tona; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ramush Ahmetaj .....

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.


Data: 14 qershor 2022, Fushë Kosovë.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.

[2] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet





HEKURUDHAT E KOSOVËS "TRAINKOS" SH.A.

Pasqyrat Financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2021

Fushë Kosovë, Mars 2022

PËRMBAJTJA

I. Deklarata e pajtueshmërisë	3
II. Pasqyra e pozicionit financiar	4
III. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	6
IV. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	7
V. Pasqyra e rrjedhës së parasë	8
VI. Shënimet e pasqyrave financiare	10-21

I. Deklaratë e Pajtueshmërisë
Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2021

Bazuar në njohurit tona më të mira, deklarojmë që pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2021, paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të vërtetë pozicionin financiar të kompanisë, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L - 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Kryeshefi ekzekutiv
Gelor Shala

Zyrtari Kryesor Financiar
Durim Krasniqi

Kontabilisti i Certifikuar
Isa Derguti

TRAINKOS J.S.C. · TRAINKOS SH.A. · TRAINKOS D.D. · Fushë Kosovë · Kosovo Polje

Fushë Kosovë, Mars 2022

II. Pasqyra e poziconit finaciar më 31.12.2021

PASURITË	Shënimi	2021	2020
Pasuritë afatshkurtra		€	€
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	400,287.08	428,590.99
Investimet financiare afatshkurtra			-
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	1,159,868.05	1,160,639.54
Stoqet	6	432,761.70	454,060.94
Pasuritë e tjera afatshkurtra	5	414,392.19	434,752.61
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		**2,407,309.02**	**2,478,044.08**
Pasuritë afatgjata			
Investimet në pjesëmarrje			-
Investimet në filiale			-
Investimet financiare afatgjata			-
Prona, pajisjet dhe impiantet	7	2,571,553.87	3,592,240.37
Prona investuese			-
Investimet në vijim	7	234,035.38	-
Pasuritë e paprekshme		12,741.27	-
Pasuritë e shtyra tatimore			-
Pasuritë e tjera afatgjata			-
Gjithsej pasuritë afatgjata		**2,818,330.52**	**3,592,240.37**
Gjithsej pasuritë		**5,225,639.54**	**6,070,284.45**
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare			-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	863,568.07	782,010.22
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër			-
Interesi i pagueshëm			-
Tatimin në fitim i pagueshëm			-
Provizionet afatshkurta			-
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkurtër			-
Detyrimet e tjera afatshkurtra	8	609,527.72	614,580.55
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		**1,473,095.79**	**1,396,590.77**
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë			-
Provizionet afatgjata			-
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatgjatë			-
Detyrimet e shtyra tatimore			-
Detyrimet e tjera afatgjata	9	695,019.36	1,397,666.08
Gjithsej detyrimet afatgjata		**695,019.36**	**1,397,666.08**
Gjithsej detyrimet		**2,168,115.15**	**2,794,256.85**

EKUITETI			
Kapitali aksionar	10	25,000.00	25,000.00
Fitimet e mbajtura	10	(2,232,261.73)	(2,013,300.34)
Rezervat e tjera	10	5,264,786.12	5,264,327.94
Gjithsej ekuiteti		**3,057,524.39**	**3,276,027.60**
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		**5,225,639.54**	**6,070,284.45**

Kryeshefi ekzekutiv
Gelor Shala

Zyrtari Kryesor Financiar
Durim Krasniqi

Kontabilisti i Certifikuar
Isa Derguti

III. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021

	Shënimi	2021	2020
		€	€
Të hyrat	11	2,813,942.45	2,414,863.25
Kostoja e shitjes	12	(1,135,334.36)	(784,919.98)
Fitimi / (humbja) bruto		**1,678,608.09**	**1,629,943.28**
Të ardhurat tjera	11	1,217,566.08	1,684,979.53
Shpenzimet e shpërndarjes	12	(1,821,558.09)	(1,769,108.56)
Shpenzimet administrative	12	(316,341.80)	(202,937.86)
Shpenzimet e zhvlerësimit	12	(1,015,562.30)	(1,112,853.75)
Fitimi / (humbja) operativ		**(257,288.02)**	**230,022.64**
Shpenzimet financiare			-
Të ardhurat financiare			-
Fitimi / (humbja) para tatimit		**(257,288.02)**	**230,022.64**
Shpenzimet e tatimit në fitim			-
Fitimi / (humbja) i/e vitit		**(257,288.02)**	**230,022.64**
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore			-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit			-
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit		**(257,288.02)**	**230,022.64**

Kryeshefi ekzekutiv
Gelor Shala

Zyrtari Kryesor Financiar
Durim Krasniqi

Kontabilisti i Certifikuar
Isa Derguti

TRAINKOS J.S.C. · TRAINKOS SH.A. · TRAINKOS D.D. · Fushë Kosovë

IV. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
Gjendja më 31 dhjetor 2019	25,000.00	(2,243,322.98)	5,299,655.62	3,081,332.64
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	230,022.64	-	230,022.64
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	(35,327.68)	(35,327.68)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	25,000.00	(2,013,300.34)	5,264,327.94	3,276,027.60
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	(257,288.02)	-	(257,288.02)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	38,326.63	458.18	38,784.81
Gjendja më 31 dhjetor 2021	25,000.00	(2,232,261.73)	5,264,786.12	3,057,524.39

Kryeshefi ekzekutiv
Gelor Shala

Zyrtari Kryesor Financiar
Durim Krasniqi

Kontabilisti i Certifikuar
Isa Derguti

TRAINKOS S.H.A. · TRAINKOS D.O. · TRAINKOS J.S.C. · Prishtinë Kosovë

V. Pasqyra e rrjedhës së parasë më 31.12.2021

	2021	2020
	€	€
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	(257,288.02)	230,022.64
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	1,015,562.30	1,112,853.75
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-
Amortizimi i pasurive të paprekshme		-
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme		-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	-	-
Të ardhurat financiare		-
Shpenzimet financiare		-
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve		-
Shpenzimet e tatimit në fitim		-
	758,274.28	**1,342,876.39**
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	771.49	302,941.14
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	21,299.24	(15,892.43)
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	20,360.42	47,846.33
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	76,505.02	(281,957.71)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	(702,646.72)	(946,116.12)
	174,563.73	**449,697.60**
Tatimi në fitim i paguar		-
Interesi i paguar		-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	**174,563.73**	**449,697.60**
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(241,652.45)	(97,280.46)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		-
Interesi i arkëtuar		-
Dividendat e arkëtuara		-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	**(241,652.45)**	**(97,280.46)**
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Deponimet e kapitalit shtesë	458.18	(35,327.68)
Rregullimet me fitime të mbajtura	38,326.63	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		-
Ripagimi i kredive dhe huave		-
Pagesat e lizingut financiar		-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	**38,784.81**	**(35,327.68)**
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	**(28,303.91)**	**317,089.46**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	428,590.99	111,501.53
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	**400,287.08**	**428,590.99**

Kryeshefi ekzekutiv
Gelor Shala

Zyrtari Kryesor Financiar
Durim Krasniqi

Kontabilisti i Certifikuar
Isa Derguti

TRAINKOS S.H.A. · TRAINKOS D.O. · TRAINKOS J.S.C. · Fushë Kosovë · Kosovo Polje

VI. Shënimet për "Pasqyrat Financiare" për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021

1. Informata të përgjithëshme

Hekurudhat e Kosovës -Trainkos - Sh.A. ("Shoqëria") është kompani aksionare e inkorporuar më 16 Gusht 2011 në datën e regjistrimit dhe sipas Regjistrimit të Biznesit të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përkatësisht Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë më datë 23 Gusht 2011 me numër regjistrimi të biznesit 70773120, kapitali fillestar i regjistruar është në shumën prej 25,000.00 Euro. Ai përbëhet nga 25 mijë aksione të zakonshme me çmim prej 1 euro për aksion. Adresa e regjistruar dhe vendi kryesor i biznesit, Hekurudhat e Kosovës -Trainkos - Sh.A. është Fushë Kosovë. Pronare e kompanisë është Qeveria e Kosovës.
Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 33 paragrafi 1, të Ligjit mbi Hekurudhat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-076, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr.01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 26 Shkurt 2010 mori Vendim mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës Sh.A.

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087, për "Kompanitë Publike"; Ligjit Nr.02/L-123, për "Shoqëritë Tregtare" dhe bazuar në vendimin e Qeverisë nr.05/110 të datës 26.02.2010 për ndarjen e Hekurudhave të Kosovës sh.a. themelon: "Shoqërinë Aksionare "Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës" Sh.A. me numër të biznesit 70773120, e cila është përgjegjëse për pasuritë, detyrimet, që rrjedhin si pasojë e këtij transformimi. Shkurtesa e emërtimit është "TRAINKOS" Sh.A.

Selia e kompanisë gjendet në Komunën e Fushë Kosovës "Sheshi i Lirisë" p.n. Kompania mund të zhvilloj aktivitetin e saj në gjithë territorin e Kosovës dhe jashtë saj.
Kompania, sipas Statutit të saj dhe Legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës mund të hapë Qendra zyra përfaqësuese, filiale, degë dhe kompani të tjera si në Republikën e Kosovës ashtu edhe jashtë vendit.

Shpërbërja (ndarja) financiare e Hekurudhave të Kosovës Sh.A. është bërë nga grupi punues i përbërë prej tetë anëtarëve bazuar në vendimin e dates 18.05.2010 Nr.571. në bazë të cilit vendim është bërë ndarja e mjeteve financiare, ndarja e borxheve dhe ndarja e obligimeve financiare në dy kompani të reja
("INFRAKOS" Sh.A. dhe "TRAINKOS" Sh.A.)

1.1.Aktivitetet biznesore të kompanisë

Aktiviteti kryesor i kompanisë është transporti hekurudhor nderurban i pasagjerëve dhe transportit i mallrave dhe shërbimet hekurudhore në baza komerciale. Rrjeti hekurudhor përbëhet prej rreth 333 km pa binar elektrifikues. Linja kryesore shkon Veri -Jug duke lidhur Maqedoninë me kufirin e Serbisë, në veri të Mitrovicës. Një linjë më tej shkon në drejtim të perëndimit nga Prishtina në Pejë dhe në drejtim të Lindjes nga Prishtina në Podujevë (Merdare-kufi me Serbinë).

2. PASQYRA E POLITIKAVE KONTABËL

2.1.Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgaditur në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi të Kosovës si dhe standardet e kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.

2.2.Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyra financiare është raport financiar për qëllime të përgjithshme i cili përgatitet në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë, me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe në harmoni me kërkesat e Këshillit Kosovar për Raportime Financiar, si dhe për nevoja të Menaxhmentit dhe shfrytëzuesve tjerë.
Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me kostot historike të pasurive dhe detyrimeve për çka ka dëshmi të mjaftueshme.

Pasqyrat financiare janë të paraqitura ne Euro, ku nuk jan përfshir decimalet e që formohen nga numrat e plotë pa '00. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe po qëse nuk ceket ndryshe, janë konsistente me ato që janë miratuar në vitin e kaluar financiar.
Përgatitja e pasqyrave financiare konform të SNRF kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkojnë menaxhmentit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proceset e aplikimit të politikave të kontabilitetit.
Periudha raportuese e Shoqërisë përfshinë një periudhë dymbëdhjetë mujore pra 01 Janar deri më 31 Dhjetor të çdo viti.

2.3.Valuta e këmbimit

Monedha raportuese e Hekurudhat e Kosovës -Trainkos - Sh.A. është njësia monetare e Unionit Europian (Euro) një herit edhe përdorimi i kësaj valute në vendin tonë, e aprovuar nga Qeveria e Kosovës së bashku me Bankën Qendrore të Kosovës.
Transaksionet e valutës së huaj konvertohen duke përdorur normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Çfarëdo lloj përfitimesh apo humbjesh, që kanë të bëjnë me harmonizimin e shumave, të pagueshme ose të arkëtueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave.

2.4. Prona, Impiantet dhe Paisjet

Vlera e pronës, impianteve dhe paisjeve të "Trainkos" më 31 Dhjetor 2021 janë bartur në bazë të parimit të konsistencës, respektivisht vazhdimësisë së vendimit të komisionit për ndarje, sipas kostos minus zhvlerësimi i aukumuluar. Kosto paraqet shpenzimin që i atribuohet direkt blerjes.
Një zë nga pajisjet dhe makineritë largohet nga pasqyra e pozicionit financiar kur shitet ose kur tërhiqet nga përdorimi dhe kur nuk pritet ndonjë benefit i ardhshëm nga ato.
Riparimet dhe mirëmbajtja (operative) ngarkohen në pasqyrën operative atëherë kur ndodhin shpenzimet.
Ngarkimi vjetor për amortizimin llogaritet duke përdorur metodën lineare për të gjitha kategoritë e pronës, toka nuk është e zhvlerësuar.
Shpenzimet pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të asetit apo janë njohur si asete të ndara, në mënyrën e duhur, vetëm atëherë kur përfitimi ekonomik i mundshëm lidhur me to mund të rrjedhë në kompani dhe vlera e mjetit mund të matet seriozisht.
Shkalla e zhvlerësimit të aseteve llogaritet sipas Sndardadeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit:

Ndërtesat	5%
Makineritë	10%
Automjetet dhe paisjet tjera	20%

2.5.Zhvlerësimet e aseteve

Prona, impiantet dhe pajisjet rishikohen për dëmtim kurdo që ndonjë ngjarje ose ndryshimet në bazë të rrethanave tregojnë se shuma bartëse e një aseti nuk mund të rikuperohet. Kurdo që vlera bartëse e një aseti e tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme, një humbje nga rënia në vlerë njihen në pasqyren e të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një aseti është çmimi më i lart shitës neto i një aseti dhe vlera në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shuma e arritshme nga shitja e një aseti në një transaksion të vullnetit të lirë, përderisa vlera në përdorim është vlera aktuale e paraparë në të ardhmen e flukseve të parasë që pritet të arrijnë nga përdorimi i vazhdueshëm të një aseti dhe nga heqja e tij në fund të jetëgjatësisë së përdorimit të tij. Vlerat e rikuperueshme llogariten për asetet individuale ose, nëse nuk është e mundur, për njësitë që gjenerojë të holla.

2.6.Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët e licencuar për kompjuter. Këto fillimisht deklarohen sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluara të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metoden lineare përderisa kostoja e një aseti të paprekshëm shlyhet përgjat kohzgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

2.7.Instrumentet financiare

Asetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur kompania bëhet pjesë e dispozitave kontraktuese të instrumentit financiar. Asetet financiare nuk njihen kur të drejtat e kontraktuara mbi rrjedhën e parasë nga aseti financiar skadon, ose kur aseti financiar dhe të gjitha rreziqet e konsiderueshme dhe shpërblimet janë transferuar. Detyrim financiar nuk njihet kur ai është shuar, shlyer, anuluar apo skaduar.
Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksioneve, me përjashtim të aseteve dhe detyrimeve financiare të bartura në vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, të cilat fillimisht janë matur me vlerën e drejtë. Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur më pas ashtu si përshkruhet më poshtë.

2.8. Mjetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë asete financiare të mbajtura për tregti. Aseti financiar klasifikohet në këtë kategori nëse kryesisht është përvetësuar për qëllim shitje në afat të shkurtër. Asetet në këtë kategori janë klasifikuar si asete qarkulluese. Kompania nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori deri në datë të raportimit.

2.9. Kreditë dhe të arkëtueshmet

Huat dhe të arkëtueshmet janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuara në një treg aktiv. Këto janë të përfshira në asetet qarkulluese, me përjashtim të kredive dhe të arkëtueshmet që kanë maturitet në më shumë se 12 muaj që nga data e pasqyres së pozicionit financiar. Kreditë dhe të arkëtueshmet e kompanisë në datën e pasqyres së poziconit financiar përbëhen nga të arkëtueshmet tjera dhe tregtare, paraja dhe ekuivalentët e parasë.

2.10.Stoqet

Stoqet e kompanisë "Trainkos" janë kryesisht materiale dhe pjesët rezervë të cilat janë të lidhura kryesisht me funksionimin e transportit hekurudhor të mallrave dhe shërbimeve. Vlera e stoqeve është vlersuar me koston historike, më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme, duke përdorur metodën e matjes mesatare dhe përfshinë shpenzimet e kryera në përvetësimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin ekzistues dhe gjendjen ekzistuese të tyre.

2.11.Llogaritë e Arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë bartur në shumat e faturuara, ndonëse nuk kemi hasur të jenë reduktuar nga provizioni i cili nuk është bërë për dëmin e tyre. Provizioni për borgjet e këqija mund të vendoset me vendime të vlefshme, kur ka evidencë objektive se kompania nuk do të jetë në gjendje ti mbledhë të gjitha shumat e pritura.

2.12.Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen në pasqyren e pozicionit financiar sipas kostos. Për qëllime të pasqyrës së rjedhës së parasë së gatshme, paraja përfshinë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

2.13.Kapitali aksionarë

Kapitali aksionarë përbëhet nga vlera monetare e kontribuar,e regjistruar në librat e kompanisë në shumën prej 25,000.00 € shumë kjo e deponuar në llogari bankare.

2.14.Rezervat

Rezervat fillimisht janë njohur në gjendjen fillestare të pasqyres së pozicionit financiar në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitalit fillestar të kontribuar nga aksionari i kompanisë.

2.15.Përfitimet e punëtorëve

Numri i të punësuarve në "Trainkos" sh.a. për vitin 2021 ka qenë 225 punonjës. Në rrjedhat normale të biznesit, entiteti bënë pagesat në emër të punëtorëve të vetë për kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhurat personale të cilat janë të kalkuluara në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrës së të ardhurave për periudhën e caktuar kohore.

2.16.Tatimi

"Trainkos" sh.a. është kërkuar që të paguajë tatim në fitimin e realizuar për çdo periudhë financiare kontabël të kalkuluar në përputhshmëri me rregulloret në fuqi, për periudhën e caktuar, si dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin dhe kontributet në të ardhura personale.
Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet e tatimit mund të barten për tu vendosur në pesë vitet pas vitit kur ka ndodhur humbja(nëse ka patur ndërmarrja).

2.17.Njohja e të ardhurave operuese

Të ardhurat janë njohur me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar për mallrat dhe shërbimet e ofruara gjatë rrjedhjes normale të aktivitetit operativ, zvogëluar nga zbritjet, lejimet të ngjashme dhe kthimet e konsumatorëve .Të hyrat njihen kur mallrat janë dorezuar dhe pronësia është bartur.

Të ardhurat njihen kur është e mundur që fitimet ekonomike lidhur me rrjedhen e transakcioneve të kompanisë dhe kur shuma e të hyrave mund të matet besueshëm dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të kompanisë janë përmbushur. Këto kritere të njohjes së aktiviteteve-specifike janë të bazuara në mallrat ose zgjidhjet e siguruar ndaj klientit dhe kushteve të kontratës në secilin rast, dhe janë përshkruar më poshtë

Të hyrat nga kontratat me çmime fikse për ofrimin e shërbimeve të transportit në përgjithësi njihen në periudhën që shërbimet janë siguruar, duke përdorur metodën drejtë-vizore mbi afatin e kontratës.

2.18.Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin e kryerjes së shërbimit ose në datën e faturimit.

2.19.Grantet qeveritare

Grantet nga qeveria janë njohur me vlerën reale ku është një siguri e arsyeshme se grantet do të mirren dhe kompania do ti përmbush kushtet e bashkangjitura.
Grantet qeveritare lidhur me blerjen e paisjeve, pronës dhe impianteve janë të përfshira në detyrimet jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyrë dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave në bazë drejtëvizore sipas shkallës së zhvlerësimit për kategorinë e caktuar.
Grantet qeveritare që lidhen me shpenzimet janë të shtyra dhe njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave gjatë periudhës së nevojshme që të përputhen ato me shpenzimet që ato kanë për qëllim për ti kompensuar.

2.20. Provizionet, detyrimet kontigjente dhe asetet kontigjente

Provizionet njihen kur detyrimet e tanishme si rezultat i një ngjarje në të kaluar mund të çojë në një fluks dalës të burimeve ekonomike nga grupi ku shumat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Koha apo shuma e daljeve mund të jetë ende e pasigurt. Një detyrim i tanishëm lind nga prania e një zotimi konstruktiv ose detyrimi ligjor që ka rezultuar nga ngjarjet e kaluara.
Provizionet maten me shpenzimet e parashikuara të nevojshme për të shlyer obligimin e tanishëm, duke u bazuar në dëshmi të besueshme në dispozicion në datën e raportimit, duke përfshirë rreziqet dhe pasigurité lidhur me detyrimin e tanishëm. Aty ku ka një numër të detyrimeve të ngjashme, gjasat që një fluks dalës do të kërkohet në shlyerje të obligimit përcaktohet duke marrë në konsideratë klasën e detyrimeve si tërësi. Provizionet zbriten në vlerën e drejtë të tyre, kur vlera kohore e parasë është materiale.
Të gjitha provizionet rishikohen në çdo datë të raportimit dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual.

2.21.Detyrimet kontigjente

Një detyrim kontigjent nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një fluks shpenzimesh është i mundshëm.

2.22.Pasuritë kontigjente

Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një fluks hyrës i përfitimeve ekonomike është i mundshëm.
Shuma e një humbje kontingjente njihet si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe një vlerësim i arsyeshëm i humbjes së shkaktuar mund të bëhet.

3. Menaxhimi i riskut financiar dhe kapital

Menaxhimi financiar i riskut të kompanisë bartet nga bordi i drejtorëve.
Objektivat e kompanisë kur menaxhojnë me kapital janë të ruajnë mundësinë që kompania të vazhdoj me punë në të ardhmen.
Kompania duhet të plotesojë nevojat për mjete financiare. për ti mbuluar shpenzimet operative që rrjedhin nga aktiviteti dhe veprimtaria e saj. Ekziston mundësia për rrezik likuditetit pasi që mjetet financiare mund të mos jenë të mjaftueshme për ti paguar detyrimet në kohë e duhur me një kosto të arsyeshme.

3.1.Risku kreditor

Mjetet financiare të cilat e vënë kompaninë në risk kreditor përbëhen prej parasë në dorë dhe parasë në llogaritë bankare.
Paraja dhe ekuivalentët e parasë të kompanisë përbëhen kryesisht nga salldot bankare.

Shpalosja e zërave në Poziten e Pasyqres Financiare

4. PARATË NË BANKË DHE ARKË

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë që entiteti i mban në arken e vet për qëllime të pageses së shpenzimeve operative dhe per nevoja tjera të pa parashikuara si dhe paratë që entiteti i ka si të depozituara në bankat tjera. Gjendja e parasë siç janë pasqyruar në pasqyren e pozicionit financiar në këtë notë është si vijonë:

Llogarit Bankare dhe paraja e gatshme	2021	2020
Investimet Kapitale	539.31	521.81
Llogaria Kryesore	281,728.79	115,873.05
Ministria e Infrastruktures	22,149.13	147,457.53
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	94,071.35	149,488.53
LlogariaKryesore ne BPB	-	12,774.45
Paraja ne arke	1,798.50	2,475.62
Total:	**400,287.08**	**428,590.99**

Paraja e gatshme në llogaritë bankare përfshijnë arkëtimin e faturav, paraja për investimet kapitale nga Qeveria, paraja nga subvencionet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Infrastruktures, dhe paraja në arkë.

5. Llogaritë e Arkëtueshme tregtare

Pasuritë afatshkurtra	2021	2020
Llogaritë e arkëtueshme	1,159,868.05	1,160,639.54

5.1. Llogaritë e arkëtueshme	
Neëco Feroonikeli	650,938.57
Infrakos Sha	270,543.09
Ballkan Shped	152,363.82
Railtrans L.L.C.	55,500.10
Fershped AD Skopje	8,044.29
Të tjera	22,488.18
Total	**1,159,868.05**

5.2. Pasuritë e tjera afatshkurtra

Pasuritë e tjera afatshkurtra	2021	2020
Llogaritë e arkëtueshme nga punëtorët	6,713.69	7,585.64
Parapagim I Tatimit (TVSH)	387,093.26	405,917.41
Llogaritë tjera të arkëtueshme (Avanset e dhëna)	20,585.24	21,249.56
Total:	**414,392.19**	**434,752.61**

6. STOQET

Gjendja e stoqeve me 31 dhjetor 2021 është shpalosur më poshtë sipas depove:

Stoqet (PJESET REZERVË)	2021	2020
Depo e administrates	25,894.55	23,552.74
Depo Naftes	20,409.94	12,625.68
Depo Vajit	11,727.63	16,039.79
Depo pjeseve rezerve	373,940.04	401,053.19
Pjesë të dëmtuara (jasht perdorimit)	-	
Stoqet e biletave të papërdorura	789.54	789.54
Total:	**432,761.70**	**454,060.94**

7. PRONA, PAISJET DHE IMPIANTET

Përshkrimi	Toka dhe Pasuria e pa zhvlersueshme	Ndërtesat e strukturat ndërtimore	Automjete Inventar, paisje, etj	Totali
Kostoja:				
Me 01 Janar 2020	229,680.00	1,427,851.34	10,774,198.63	12,431,729.97
Shtesë	-	84,568.60	23,786.86	108,355.46
Nxjerrje jashta përdorimit	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2020	229,680.00	1,512,419.94	10,797,985.49	12,540,085.43
Shtesë		234,035.38	7,617.07	241,652.45
Nxjerrje jashta përdorimit	-	0	-	0.00
Me 31 Dhjetor 2021	229,680.00	1,746,455.32	10,805,602.56	12,781,737.88
Zhvlersimi i akumuluar:		-487,523.24	-7,347,468.07	-7,834,991.31
Zhvlersimi i viti 2020	-	-79,352.11	-1,033,501.64	-1,112,853.75
Me 31 Dhjetor 2020	-	-566,875.35	-8,380,969.71	-8,947,845.06
Zhvlersimi i vitit 2021	-	-77,265.48	-938,296.82	-1,015,562.30
Me 31 Dhjetor 2021	-	**-644,140.83**	**-9,319,266.53**	**-9,963,407.36**
Vlera neto kontabël 31 Dhjetor 2020:	**229,680.00**	**945,544.59**	**2,417,015.78**	**3,592,240.37**
Vlera neto kontabël 31 Dhjetor 2021:	**229,680.00**	**1,102,314.49**	**1,486,336.03**	**2,818,330.52**

8. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

Detyrimet afatshkurtra	2021	2020
Llogaritë të pagueshme	863,568.07	782,010.22

8 Llogaritë e pagueshme tregtare

Infrakos Sha	*533,707.30*
Hib Petrol Sh.p.k.	*168,525.72*
Macedonia Railëays	*73,204.65*
Telekomi I Kosovës Sh.A.	*24,047.37*
Sankos Sh.p.k.	*19,313.00*
Të tjera	*44,770.03*
Totali	***863,568.07***

8.1. Detyrimet e tjera afatshkurtra

Detyrimet e tjera afatshkurtra	2021	2020
Obligimet ndaj të punësuarëve	1,117.61	6,188.23
Obligimet për tatime	288,491.19	345,001.61
Obligimet për kontribute	319,918.92	263,390.71
Total:	***609,527.72***	***614,580.55***

9. DETYRIMET TJERA AFATGJATA

Në detyrimet afatgjata përfshihen grantet për investime kapitale të marrura nga Buxheti i Kosovës. Vlera e paraqitur në pasqyren e pozicionit financiar është që prej themelimit të kompanisë, kjo vlerë zvogëlohet me të ardhurat e shtyra, në bazë të shpenzimeve të zhvlerësimit.

Detyrimet e tjera afatgjata	2021	2020
Të hyrat e shtyra në fillim të vitit	**1,397,666.08**	2,343,782
Të hyrat e shtyra gjatë vitit	279,728.89	138,863.61
Shpenzimet zhvlerësimit të granteve	(982,375.61)	-1,084,980
Të hyrat e shtyra në fund të vitit	**695,019.36**	**1,397,666**

10. EKUTETI AKSIONAR DHE REZERVAT

Ekuteti aksionar dhe rezervat përbëhen nga kapitali themelues, kapitali rezervë, fitimet (humbjet) e bartura dhe fitimi (humbja) e vitit financiar.

Ekuteti Aksionardhe rezervat	2021	2020
Kapitali themelues	25,000.00	25,000.00
Kapitali	5,264,786.12	5,264,327.94
Fitimet/Humbjet e bartura	(1,974,973.71)	(2,243,322.98)
Fitimi/Humbja e vitit financiar	(257,288.02)	230,022.64
Total:	**3,057,524.39**	**3,276,027.60**

Fitimet/Humbjet e bartura janë zvogëluar për 38,326.63€ në bazë të raportit për llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme i cili është përgatitur nga komisioni për rregullimin e llogarive të pagueshme dhe arkëtueshme dhe i aprovuar nga bordi i drejtorëve.

11. TË HYRAT

Të hyrat e kompanisë si aktivitet kryesor kanë transportin e mallrave dhe udhëtareve dhe shërbimet për ta:

Të hyrat	2021	2020
Të hyrat nga transporti i mallrave	1,092,660.76	715,284.86
Të hyrat nga transporti i udhëtareve	51,406.11	49,045.04
Shërbimet tjera	6,321.90	23,039.84
Të hyrat nga Ministria e Infrastruktures	1,007,403.78	1,074,861.90
Të hyrat nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik	576,278.04	500,000.04
Të ardhurat nga shitja e naftes Infrakos	22,881.33	18,854.28
Të ardhurat nga shitja e skrapit	2,064.42	0.00
Të ardhurat nga dëmtimi i vagonëve dhe të tjera	22,210.54	8,956.60
Të ardhurat nga zbritjet e marrura	(1,406.21)	(31,151.81)
Të ardhura tjera	34,121.78	55,972.50
Total:	**2,813,942.45**	**2,414,863.25**

Gjatë vitit 2021 kompania ka realizuar edhe këto të ardhura tjera:

Të ardhurat tjera	2021	2020
Të ardhurat e shtyra	982,375.61	1,084,979.53
Të ardhura të jashtëzakonshme	-	600,000.00
Të ardhurat nga shitja e pasurisë	235,190.47	-
Total:	**1,217,566.08**	**1,684,979.53**

12. SHPENZIMET

Kompania gjatë vitit 2021 ka realizuar këto shpenzime të cilat janë paraqitur në tabelen e mëposhtem:

SHPENZIMET	2021	2020
Kostoja e sherbimeve	1,135,334.36	784,919.98
Kostoja e punes	1,821,558.09	1,769,108.56
Shpenzimet e administrates	83,822.08	116,667.68
Shpenzimet operative	232,519.72	86,270.17
Shpenzimet e zhvlersimit	1,015,562.30	1,112,853.75
Total:	**4,288,796.55**	**3,869,820.15**

Në koston e shërbimeve bëjnë pjesë derivatet dhe lubrifikantet në vlerë prej 562,969.76€, qasja në binarë në vlerë prej 367,126.58€, pjesë rezerv vlera prej 28,780.21€, tërheqja e trenave vlera prej 123,699.67€ dhe të tjera 52,758.14€.

13. DETYRIMET, PASURITË KONTIGJENTE

Gjatë vitit 2021 janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme më qëllim të përfaqësimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së interesave të ndërmarrjes si dhe në asistimin në mbikëqyrjen e hartimit dhe implementimit të Rregulloreve dhe akteve juridike të aplikueshme në Trainkos Sh.A.

Kompania ka vlerësuar se detyrimet kontigjente dhe provizonet nuk i kanë plotësuar kushtet të regjistrohen si provizione në pasqyrat financiare. Kompania ka bërë ndarjen e detyrimeve dhe provizoneve ne kategorit qe jane:
Lëndë në kontestet kompenzim dëmi janë gjithsej 23 lëndë prej tyre 19 janë në cilësin e paditur vlera që parashihet është 871,755.22€. Ndërsa lëndët në cilësin e paditëses janë 4 në vlerë prej 69,829.87€.
Lëndët në marrëdhëniet e punës janë gjithsej 10 në vlerë prej 193,676.98€.
Lëndët për pagim të borxhi janë 2 si të Paditur në vlerë prej 36,319.85€.

14. NGJARJET PAS PËRFUNDIMT TË PERIUDHËS RAPORTUESE

Nuk ka patur ngjarje pas përfundimit të periudhës raportuese.

15. TRANSKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Nuk ka patur transaksione me palët e lidhura (indirekt e as direkt).

16. PARIMI I VIJIMËSISË

Vijimësia e kësaj Organizate nuk është e rrezikuar për vitin 2022, këtë e mundësojnë kontratat e nënshkruara me klientët, marrëveshjet e nënshkruara me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

17. APROVIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga bordi i drejtorëve, Mars 2022 dhe janë autorizuar për publikimin e tyre.